



Tifozet kuqezi pak dite para ndeshjes Shqiperi-Zvicer kane bere nje leter te hapur te drejtuar per lojtaret shqiptare qe luajne per Zvicren. Nepermjet kesaj letre u kane kerkuar atyre te mos luajne te premten ne “Qemal Stafa” kunder atdheut te tyre. “Jo rrallehere per t’iu kundervuar kritikave te shumta pse ju keni zgjedhur per te perfaqesuar nje vend tjetër e jo vendin e origjines ju i jeni pergjigjur se e doni shume Shqiperine, se ndiheni shqiptare ashtu sikurse ndihen shume familje shqiptare qe emigruan per nje mireqenie me te mire ne vende te tjera. Meqenese keni rrenje shqiptare dhe nuk ndiheni rahat te luani kunder Kombit te rrenjeve tuaja (ashtu siç edhe deklaroni neper media ), ju kerkojme qe te mos luani ne ndeshjen kunder Shqiperise ne Tirane. Mendojme se ne kete menyre do t’jeni korrekt edhe me ngjyrat qe i prezantoni, pasi qe ata do t’ju kuptojne. Nese veproni ndryshe dhe nuk jeni ne ditën e juaj me te mire, atehere ata (zviceranet) do t’ju quajne ‘tradhtare’ Mirepo, nese eventualisht shenoni gol, atehere bashkekombasit e juaj (Ne) te anes tjetër do t’ju quajme po me te njejtin emer. Besojme shume se kjo do te ishte zgjidhja me e mire per te gjitha palet. Ju kujtojme se ne nje rast te tille ish reprezentuesi i Kombetares polake te basketbollit Dardan Berisha nuk u paraqit fare ne ndeshjet eliminatorë qe Polonia i zhvilloi kunder Shqiperise, sepse sipas tij “ Nuk mund te luante kunder vendit te tij”, shkruhej ne letren e tifozëve kuqezi.